



European
Union
Kosovo

QËNDRIM PËR LIGJIN PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

Prill 2020



Qëndrimi për Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare është hartuar nga Grupi Tematik për Mbrojtje të Fëmijëve në kuadër të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF, në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit, Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe Lidhjen e QPS-ve të Kosovës.

Dokumenti në vetvete përmban shtatë propozime kryesore si dhe arsyetimet përkatëse për secilin propozim, për tu përfshirë në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare. Ky qëndrim do ti prezantohet dhe vijë në ndihmë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale e cila është bartëse e procesit të hartimit të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Qëndrimi i përbashkët mes KOMF, Institucionit të Avokatit të Popullit, Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Lidhjes së QPS-ve, do të jetë gjithashtu edhe në dispozicion të gjithë partnerëve, institucioneve dhe palëve të tjera të interesit.

Ky qëndrim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e vetme e Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.

Qëndrimi për Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare është prodhuar në kuadër të projektit “Aksioni i Përbashkët për Decentralizim” (Joint Action for Decentralization), financuar nga Bashkimi Europian, menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë dhe implementuar nga KOMF në partneritet me Organizatën për fëmijët pa kujdes prindëror – OFAP, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe KMOP.

HYRJE

Kosova është duke zhvilluar procesin për reformën e shërbimeve sociale dhe familjare, ku vend të rëndësishëm zë edhe legjislacioni i orientuar për garantimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë, në pajtim me Kushtetutën, Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Kornizën Vullnetare Europiane për Cilësinë e Shërbimeve Sociale dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare. Në këtë drejtim, një ndër nismat legjislative është hartimi i Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF sipas vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka qenë pjesë e grupit punues për hartimin e koncept dokumentit për plotësim ndryshimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, ku ka adresuar qëndrimin dhe rekomandimet për këtë koncept dokument. KOMF ka propozuar që koncept dokumenti për Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, duhet të adresojë dhe përfshijë propozimet lidhur me: a) Përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale, fuqizimin e shërbimeve për parandalim dhe reintegrim; b) Organizimin e shërbimeve sociale dhe familjare (fuqizimi i një skeme të hapur të ofrimit të shërbimeve në mes të ofruesve publik dhe joqeveritar/privat); c) Integrimin e shërbimeve sociale dhe familjare me shërbimet shëndetësore dhe arsimore; d) Zhvillimin dhe fuqizimin e shërbimeve në familje dhe shërbimeve me bazë në komunitet, reformimi i formave të mbrojtjes; e) Rritjen e cilësisë së shërbimeve; f) Llogaridhënien dhe g) Financimin e shërbimeve sociale.

KOMF vlerëson faktin që MPMS ka përfshirë dhe ka adresuar në tërësi propozimet e KOMF në kuadër të koncept dokumentit për hartimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, i cili është aprovuar nga Qeveria e Kosovës në Shkurt të 2019.

Tani, KOMF si pjesë e grupit punues për hartimin e Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare është duke mbështetur reformën

në fushën e shërbime sociale përmes hartimit të Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare.

KOMF ka zhvilluar një seri konsultimesh me organizatat anëtare për të sjellë qëndrimet e aktorëve kyç të shoqërisë civile lidhur me hartimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare. Krahas konsultimeve, Grupi Tematik për Mirëqenie dhe Mbrojtje të Fëmijëve i përbërë nga organizatat anëtare të KOMF, Institucioni i Avokatit të Popullit, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Lidhja e QPS-ve, kanë mbajtur punëtori për hartimin e qëndrimit të përbashkët lidhur me hartimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Ky dokument përmban qëndrimin e KOMF, Institucionit të Avokatit të Popullit, Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Lidhjes së QPS-ve me propozimet dhe arsyetimet përkitazi me hartimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

KOMF, Institucioni i Avokatit të Popullit, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Lidhja e QPS-ve, propozojnë që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, të adresojë dhe përfshijë propozimet si më poshtë.

PROPOZIMI 1

Rekomandohet që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare të parashikojë një reformë sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale, duke përcaktuar shërbimet e parandalimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe re integrimit, si dhe duke i klasifikuar shërbimet në tri kategori/ nivele, duke garantuar kështu të drejtën në shërbime sociale për të gjithë fëmijët dhe personat në nevojë për shërbime sociale, pa marrë parasysh nivelin e urgjencës apo rrezikshmërisë.

■ **Kategoria 1:**

Shërbimet primare të parandalimit janë shërbime të përgjithshme të ofruara si ndërhyrje e hershme, në familje, komunitet dhe shoqëri.

Shërbimet sociale primare ofrohen për të zvogëluar rrezikun e personave të identifikuar si të cenueshëm apo në rrezik për tu viktimizuar. Shërbimet primare përfshijnë por nuk kufizohen në: Këshillimin për përmirësimin e gjendjes së individit dhe familjes, orientimin e tyre drejt mundësive për nevojat e tyre në sistemin e shërbimeve sociale; Këshillim për prindësi të mirë, ndihmë në tejkalimin e vështirësive familjare; ndihmë për banim; Shërbime të kujdesit ditor për fëmijët dhe të rriturit, integrim shoqëror dhe aktivitete argëtuese; Trajnim dhe aftësim profesional për të ndihmuar një person për punësim; Mbështetje ligjore dhe ndihmë juridike falas; Mbështetje psikologjike në institucione të mirëqenies sociale, ato arsimore dhe shëndetësore, si dhe në sektorin joqeveritar e atë privat; Ndihmë direkte në shtëpi si furnizimi me ushqim apo ilaçe, mbështetje për ruajtjen e higjienës personale, për plotësimin e nevojave të tjera të përditshme, etj;

■ **Kategoria 2:**

Shërbimet sociale sekondare janë shërbime të specializuara që ndërhyjnë në jetën e individit kur personi që merr shërbimin është në rrezik dhe nevojë për mbrojtje.

Këto shërbime janë të nevojshme për trajtimin dhe zvogëlimin e rrezikut dhe trajtojnë pasojat negative të ardhura nga përjetimet

e këqija siç janë trauma, dhuna, etj. Shërbimet sekondare përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: Shërbime të specializuara shëndetësore siç janë ekzaminimi klinik mjeko-ligjor për viktimat e përdhunimit, të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore, etj; Shërbime këshillimi terapeutik në raste të traumës, depresionit, mendimeve vetëvrasëse, etj; Programi dhe shërbimet e rehabilitimit dhe ri-integrimit; Shërbimet përgatitore mbështesin programe për të fuqizuar individët për një jetë të pavarur; Programet për trajtimin e viktimave të abuzimit me substanca psikotrope dhe përdoruesit e këtyre substancave, etj.

Kategoria 3:

Shërbimet terciare janë shërbimet sociale intensive që ofrohen 24/7 për njerëzit në rrezik ose viktima. Shërbimet përfshijnë, por nuk kufizohen në: Shërbimi i kujdestarisë; Strehimi familjar; Shërbimet në shtëpi me bazë në komunitet/strehim rezidencial për kujdesin e fëmijëve; Mbështetja/jeta gjysmë e pavarur.

Arsyetim:

Ligji në fuqi për Shërbime Sociale dhe Familjare është kryesisht i orientuar drejt shërbimeve për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale, duke lënë anash shërbimet e parandalimit dhe re integrimit. Për shkak të kufizimeve në burime njerëzore dhe buxhetore, aktualisht shërbimet sociale janë të fokusuara

në ofrimin e shërbimeve emergjente, të mbrojtjes, dhe ka mungesë të ofrimit të shërbimeve të parandalimit dhe re integrimit, të cilat janë të domosdoshme për mirëqenien e fëmijëve dhe personave në nevojë për shërbime sociale¹. Legjislacioni në fuqi, por edhe kapacitetet e limituara financiare dhe njerëzore kanë krijuar sistemin e shërbimeve sociale në Kosovë, ku sistemi trajton dhe menaxhon rastet e rënda emergjente të cilëve ju rrezikohet jeta, siguria apo mirëqenia apo “rastet pasi kanë rënë viktimë e ndonjë forme të abuzimit”. Si pasojë, vetëm një pjesë e vogël e qytetarëve në nevojë kanë të drejtën dhe mundësinë të përfitojnë nga shërbimet dhe programet sociale. Për më tepër për disa prej fëmijëve apo personave në nevojë për shërbime sociale, sistemi nuk ofron asnjë shërbim, si bie fjala për fëmijët apo personat viktima të abuzimit me substanca narkotike.

Sistemi i shërbimeve sociale në Kosovë duhet të zhvillojë shërbimet parandaluese, rehabilituese dhe re integruese, tu dalë në ndihmë qytetarëve, të parandalojë abuzimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut si dhe të ofrojë mbështetje për rehabilitimin dhe re integrimin e tyre.

Për më tepër, planifikimi dhe ofrimi i shërbimeve për parandalim, ul koston financiare shtetërore për mbrojtje dhe shërbime sociale si dhe ul shkallën e ri viktimizimit apo recidivizimit.

¹ Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës 2.0, KOMF 2018

PROPOZIMI 2

Propozohet që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare të përcaktojë integrimin e shërbimeve sociale me shërbimet shëndetësore dhe arsimore.

Ekzistojnë modele të ndryshme të integritit të shërbimeve sociale me sektorët e tjerë. KOMF, Institucioni i Avokatit të Popullit, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Lidhja e QPS-ve ofrojnë disa nga alternativat të cilat mundësojnë integrimin e këtyre shërbimeve.

Integrimi i shërbimeve sociale mund të bëhet përmes punësimit të profesionistëve punëtorë social në kuadër të institucioneve arsimore dhe shëndetësore apo përmes specializimit të një numri të caktuar të profesionistëve aktual shëndetësor dhe arsimor në fushën sociale përmes trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve. Alternativa e parë siguron shërbime më cilësore, por që mbart kosto më të lartë financiare në implementim. Alternativa e dytë, nuk siguron cilësi sikurse alternativa e parë, por është më kosto efektive.

Ligji për Shërbime Sociale me qëllim të integritit të shërbimeve sociale në sektorët e tjerë, duhet të përcaktojë që punëtorët social të QPS të realizojnë vizita të rregullta sistematike në institucione parashkollore dhe shkolla për të bërë identifikim të hershëm dhe menaxhim të rasteve.

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare duhet të parashohë integrimin e shërbimeve sociale me sektorin e shëndetësisë përmes realizimit të vizitave sistematike në shtëpi bashkë me profesionistët shëndetësor, për të njohur dhe evidentuar vulnerabilitetin e rasteve brenda komunës.

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare duhet të parashohë integrimin e shërbimeve sociale me sektorët e tjerë përmes krijimit të protokoleve integruese për referim dhe trajtim të rasteve si dhe përmes krijimit të databazës së integruar me sektorët e tjerë, sektorin e arsimit dhe shëndetësisë.

Duke qenë që integrimi i shërbimeve kërkon konsensus me sektorët e tjerë, rekomandohet pajtueshmëria mes sektorëve të përfshirë

në nivel qendror para aprovimit të këtij ligji. Modelet e integritit të shërbimeve të cilat do të aplikohen në kuadër të këtij ligji, duhet të diskutohen dhe të përcaktohen në bashkëpunim me të gjithë sektorët e mësipërm.

Arsyetim:

Sipas raporteve dhe studimeve në Kosovë, shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve nuk janë të integruara mes sektorëve që prekin të drejtat e fëmijëve. Për pasojë edhe shërbimet sociale nuk janë të integruara me sektorin e shëndetësisë dhe atë të arsimit. Duke parë rëndësinë e madhe për një sistem të integruar të shërbimeve për fëmijët, rekomandohet që integrimi i shërbimeve sociale dhe familjare me sektorët e tjerë të adresohet në kuadër të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Aktualisht, në mungesë të stafit punëtor social në institucionet arsimore, nuk zhvillohet punë sociale në parandalim të fenomeneve negative tek fëmijët, identifikim të hershëm dhe menaxhim të rasteve. Në disa shkolla ka psikologë, megjithatë roli i psikologëve është i orientuar në fushën e këshillimit psikologjik.

Qendrat për Punë Sociale nuk kanë të dhëna për problemet apo rastet sociale në kuadër të institucioneve arsimore. Për momentin, qasja e QPS është reaktive, në pritje të klientëve apo rasteve sociale, përderisa mungon qasja proaktive drejt identifikimit të rasteve përmes vizitave apo punës në familje institucione

parashkollore, shkolla dhe komunitet. Kjo qasje pamundëson që Komuna të njohë problemet sociale apo të ketë të dhëna për cënueshmërinë brenda komunës.

Një model i mirë i integritit të shërbimeve janë vizitat sistematike në shtëpi. Aktualisht, një model i tillë në Kosovë praktikohet nga profesionistët shëndetësorë të kujdesit parësor përmes vizitave sistematike mjekësore në shtëpi të realizuara nga profesionistët në kuadër të Qendrave të Mjekësisë Familjare. Vizitat në shtëpi synojnë të sigurojnë mbrojtje shëndetësore për grupet e cënueshme të popullatës, me theks të veçantë kategorinë e nënave dhe fëmijëve. Ky model do të ishte i përshatshëm edhe për shërbimet sociale për të evidentuar rastet në nevojë për shërbime sociale. Duke qenë se vizitat në shtëpi realizohen në kuadër të sektorit të shëndetësisë, një pajtueshmëri dhe bashkërendim paraprak në mes të MPMS dhe MSH është i domosdoshëm para përfshirjes së këtij modeli në këtë ligj. Vizitat sistematike në shtëpi mund të realizohen bashkarisht me profesionistët shëndetësorë, kështu duke ofruar shërbime shëndetësore dhe sociale në mënyrë të integruar.

Aktualisht, nuk ka protokole identifikimi, referimi të integruara për rastet e fëmijëve. Në Kosovë ka protokole të veçanta sa i përket referimit të rasteve të dhunës në familje, por jo për kategoritë e tjera. Po ashtu nuk ka një databazë të integruar sa i përket rasteve të fëmijëve në mes të sektorëve. Secili sektor posedon të dhënat sipas databazës së vet.

PROPOZIMI 3

Propozohet që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare të përcaktojë organizimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe të fuqizojë një skemë të hapur të ofrimit të shërbimeve në mes të ofruesve publik, joqeveritar dhe privat.

Gjithashtu rekomandohet përcaktimi i qartë i shërbimeve sociale të cilat mund të kontraktohen, shërbimeve që mund të ofrohen në bashkëpunim me ofrues të tjerë dhe shërbimeve që nuk mund të kontraktohen por ofrohen ekskluzivisht nga sektori publik.

Arsyetim:

Kosova është duke ndjekur politikën e zhvillimit të partneritetit në mes të autoriteteve publike dhe organizatave jo-qeveritare të cilat ofrojnë shërbime, duke vendosur kështu një skemë të hapur dhe të qëndrueshme bashkëpunimi dhe financimi për shërbimet sociale. Megjithatë kjo politikë dhe ky partneritet duhet fuqizuar në kuadër të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare².

Në shumicën e shteteve në Europë, kuadri ligjor lejon autoritetet nacionale, rajonale dhe lokale që të transferojnë shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve në sektorin jo qeveritar/privat dhe / ose të nënkontraktajnë organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat.

Në Europë organizatat e shoqërisë civile po luajnë gjithnjë një rol më të rëndësishëm, duke u bërë ofrues të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, siç janë shërbimet sociale primare, shërbimet për kujdes alternativ, strehimin rezidencial, shërbimet përmes qendrave ditore dhe shërbimet në komunitet, shërbime këto të cilat tradicionalisht më parë janë ofruar vetëm nga institucionet publike.

Në të paktën 18 shtete (Austria, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Italia,

² Financimi i shërbimeve sociale në Kosovë, 2017 KOMF

Letonia, Lituania, Malta, Holanda, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar) korniza ligjore lejon nënkontraktimin dhe/ose dhënien e shërbimeve alternative të kujdesit tek institucionet jo qeveritare dhe private.

Në shtetet e tjera, si Bullgaria, Kroacia dhe Lituania, përkundër dispozitave ligjore ekzistuese, në praktikë, deri më tani, shërbimet sociale janë nënkontraktuar dhe / ose jepen vetëm tek organizatat e shoqërisë civile³.

Skema e hapur dhe e qëndrueshme e ofrimit të shërbimeve sociale në mes të institucioneve publike, sektorit joqeveritar dhe privat, ofron mundësi

për gamë më të gjerë të ofrimit të shërbimeve sociale, shërbime të specializuara dhe më cilësore si dhe kosto më të ulët buxhetore për shtetin e Kosovës.

Rekomandohet që kjo çështje, në mënyrë specifike të rregullohet tek Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, duke përcaktuar shërbimet sociale të cilat nuk mund të kontraktohen (ato të cilat duhet të ofrohen vetëm nga institucionet publike), shërbimet sociale të cilat mund të ofrohen në bashkëpunim me organizatat jo qeveritare dhe private si dhe shërbimet sociale që mund të kontraktohen nga sektori joqeveritar dhe privat.

³ Studimi për sistemet e mbrojtjes së fëmijëve, Agjencia e Bashkimit Europian për të Drejtat të Njeriut

PROPOZIMI 4

Propozohet zhvillimi dhe fuqizimi i shërbimeve në familje dhe shërbimeve me bazë në komunitet, zgjerimi i formave të mbrojtjes, konkretisht:

- a) Zhvillimi i strehimit familjar pas arritjes së moshës 18 vjeçare
- b) Zhvillimi i formës së mbrojtjes “Jetesa e pavarur e mbikëqyrur”

Arsyetim:

Zhvillimi i strehimit familjar pas arritjes së moshës 18 vjeçare

Ky propozim bazohet në respektimin e interesit më të mirë të fëmijës, nevojat e fëmijëve pa kujdes prindëror në Kosovë për tu zhvilluar në familje pas moshës 18 vjeçare, ligjet dhe praktikatat e shteteve të Europës dhe Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ.

Sipas këtij propozimi, kjo formë e mbrojtjes mundëson që fëmija të vazhdojë të qëndrojë në strehim familjar edhe pas arritjes së moshës 18 vjeçare, konkretisht deri në moshën 26 vjeç. Në anën tjetër, kjo si formë përveç që është më e mirë për zhvillimin fizik dhe psikologjik, ka edhe kosto më të ulët financiare për institucionet shtetërore, duke qenë se strehimi familjar është llogaritur të ketë tri herë kosto më të ulët se strehimi rezidencial.

Ligji në fuqi për Shërbime Sociale dhe Familjare përcakton strehimin familjar vetëm deri në moshën 18 vjeçare. Për shkak të pengesave ligjore, në pamundësi që fëmija të qëndrojë në familjen strehuese pas moshës 18 vjeçare, Organi i Kujdestarisë është i detyruar të ndërpresë kujdesin dhe shërbimet, apo në rastet kur fëmija është me aftësi të kufizuara, ta vendosë fëmijën në Institutin në Shtime (strehim rezidencial), gjë që ndikon negativisht në mirëqenien e përgjithshme të fëmijës.

Praktika në Kosovë tregon që fëmija pas arritjes së moshës 18 vjeçare nuk është domosdoshmërisht i përgatitur për të përballuar jetesën në mënyrë të pavarur. Kjo vjen si rezultat i asaj që fëmija vazhdon studimet apo aftësimin profesional, mund të ketë vështirësi për sigurimin e strehimit, sigurimin e të ardhurave për mbijetesë, mund të ketë pengesa në zhvillimin psiko-fizik apo fëmija nuk është në gjendje të përkujdeset për veten e tij/saj.

Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ (2009) i kushtojnë shumë vëmendje nevojave dhe të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve që për shkak të moshës largohen nga sistemi i përkujdesjes. Kështu, shumica e shteteve janë duke e zgjatur moshën e kujdesit, ku fëmijët edhe pas moshës 18 vjeçare vazhdojnë të marrin mbështetje dhe shërbime deri në moshën 25-26 vjeçare, derisa të përfundojë arsimi i plotë, aftësimi profesional dhe pavarësimi i tyre.

Zhvillimi i formës së mbrojtjes “Jetesa e pavarur e mbikëqyrtur”

Rekomandohet që Ligji për Shërbime Sociale të rregullojë formën e mbrojtjes “Jetesa e pavarur e mbikëqyrtur”, si një nga format e reja të mbrojtjes së posaçme të fëmijëve dhe të rinjve, që nënkupton vazhdimin e qëndrimit të fëmijës në formën e kujdesit dhe marrjen e shërbimeve edhe pas moshës 18 vjeçare.

Qëllimi kryesor i kësaj forme të mbrojtjes është që fëmijët, të rinjtë që i janë besuar institucioneve/organizatave të kujdesit alternativ, të jenë në gjendje të jetojnë në mënyrë të pavarur. Puna për arritjen e këtij qëllimi fillon nga momenti i pranimit të fëmijës në kujdes alternativ dhe vazhdon deri në ditën e largimit të tij/saj, dhe kjo bëhet me përpjekjet e të gjithë bashkëpunëtorëve të kujdesit alternativ. Qëllimi është që të rinjtë në kujdes alternativ të fillojnë të kujdesen për veten, të fillojnë të menaxhojnë jetën e tyre të përditshme dhe të sigurojnë një punë me të ardhura të mjaftueshme.

Udhëzuesi për Kujdesin alternativ për Fëmijë e cilëson Jetesën e Pavarur të Mbikëqyrtur si një pjesë të rëndësishme të përbushjes së kriteve nacionale për të drejta të fëmijëve. Nenet 130, 132 dhe 135 të Udhëzimeve të KB për Kujdes Alternativ theksojnë që:

“Agjensitë shtetërore dhe organizatat e ndryshme të cilat punojnë në këtë fushë, duhet të kenë politika të qarta dhe të vazhdojnë procedurat e parapara me të rinjtë që të sigurojnë kujdes të duhur pasues dhe/ose përcjellje të mëtejshme të rastit. Përgjatë periudhës së kujdesit, ata sistematikisht duhet të synojnë përgatitjen e secilit fëmijë që të krijojë vetë-qëndrueshmëri dhe të integrohet plotësisht në komunitet, përmes fitimit të shkathtësive sociale dhe jetësore, të cilat mbështeten edhe me pjesëmarrjen e tyre në komunitet.”

PROPOZIMI 5

Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve sociale, propozohet që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare të parashikojë:

- Profilizimin e punëtorëve social/zyrtarëve të shërbimeve sociale sipas kategorive të përfituesve të shërbimeve
- Akreditimin e programeve të trajnimeve për shërbime sociale dhe edukimin e vazhdueshëm, sipas profilizimit
- Licencimin e shërbimeve publike të ofruara nga QPS, licencimin e subjekteve (sektorit jo qeveritar dhe atij privat) dhe punëtorëve social

Arsyetim:

Aktualisht punëtorët social/zyrtarët e shërbimeve sociale nuk janë të profilizuar dhe si pasojë punojnë me të gjitha lëndët dhe kategoritë në nevojë. Për të rritur cilësinë e shërbimeve si dhe performancën e ofruesve të shërbimeve, rekomandohet që ligji i ri të parashikojë profilizimin e punëtorëve social/zyrtarëve të shërbimeve sociale sipas përfituesve. Duke pas parasysh burimet njerëzore të kufizuara, rekomandohet që ky proces të zhvillohet gradualisht në mënyrë progresive. Si fazë e parë, rekomandohet profilizimi i punëtorëve social/zyrtarëve të shërbimeve sociale për punën me fëmijë dhe me të rritur. Përderisa, më tutje të bëhen planifikimet për profilizim edhe sa i përket ndarjes në kategori. Po ashtu rekomandohet që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare të harmonizohet me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve sa i përket organizimit të zyrtarëve të shërbimeve sociale, duke qenë se ky ligj parashih zyrtarët për mbrojtjen e fëmijëve në kuadër të QPS.

Aktualisht, nuk ka programe të akredituara të trajnimeve për shërbime sociale. Ligji në fuqi për Shërbime Sociale dhe Familjare nuk parashikon mënyrën e akreditimit të programeve për shërbime sociale. Ligji i ri duhet të adresojë këtë çështje e cila do të ndikojë në rritjen e cilësisë.

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare në fuqi nuk parasheh licencimin e shërbimeve publike të ofruara nga QPS-të apo institucionet e tjera publike. Rekomandohet të zbatohet procesi i licencimit të detyrueshëm për shërbimet publike të ofruara nga QPS ose institucionet e tjera publike.

Licencimi i shërbimeve të ofruara nga institucionet publike do të sigurojë llogaridhënie dhe monitorim të mëtejshëm të të gjithë ofruesve të shërbimeve publike, duke ndikuar kështu në rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale.

PROPOZIMI 6

Me qëllim të rritjes së llogaridhënies, propozohet që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare të parashikojë:

- Përcaktimin e qartë të mekanizmave të raportimit dhe monitorimit
- Fuqizimin e inspektimit/krijimin e inspektimit të pavarur
- Aplikimin e masave, gjobave dhe sanksioneve
- Monitorimin dhe vlerësimin e jashtëm nga sektori joqeveritar dhe privat

Arsyetim:

Përkundër faktit që qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për Decentralizimin ka qenë decentralizimi i shërbimeve sociale dhe definimi i rolit dhe përgjegjësi të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal në Kosovë, ende ekzistojnë paqartësi të përgjegjësi tek përfaqësuesit e institucioneve. Ofruesit e shërbimeve sociale në kuadër të QPS dhe përfaqësuesit nga komunat deklarojnë se ende ekzistojnë paqartësi në ndarjen e detyrave, kompetencave dhe përgjegjësi në mes të dy niveleve atij qendror dhe komunal, gjë kjo e cila po shkakton konfuzion⁴. Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2013 për Licencimin e Subjekteve Juridike/Organizatave që ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, nenit 19 të tij “Monitorimi dhe Inspektimi”, monitorimi dhe inspektimi duhet të bëhen nga niveli qendror. KOMF, bazuar në praktikën e shteteve tjera, propozon që monitorimi duhet të ndahet nga inspektimi dhe të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e secilit nivel. KOMF propozon që procesi i monitorimit të zhvillohet nga komuna, përderisa inspektimi të bëhet nga MPMS.

Përfundimet e Indeksit për Mbrojtjen e Fëmijëve 2.0 të publikuar nga KOMF, paraqesin rezultate të dobëta të llogaridhënies në të

⁴ Të dhënat nga procesi i monitorimit të decentralizimit të shërbimeve sociale nga KOMF, 2019

gjitha fushat e shërbimeve sociale. Rezultatet e dobëta vinë pjesërisht nga fakti që inspektimi realizohet nga njësi që vepron brenda ministrisë, mungesa e qartësisë dhe dallimit të mandatit monitorues dhe inspektues brenda të njëjtës njësi të MPMS, mos pasja e kompetencave ekzekutive dhe mos aplikimi i masave, gjobave dhe sanksioneve.

Aktualisht, njësia e monitorimit/inspektimit vepron brenda DPSF dhe ka si fushëveprim monitorimin dhe inspektimin edhe të Panelit për Vendosje të Fëmijëve dhe Adoptim i cili vepron po ashtu brenda DPSF, duke krijuar konflikt interesi dhe duke cënuar pavarësinë e procesit të inspektimit.

Propozohet shndërrimi i njësisë së brendshme të inspektimit në një njësi apo agjensi jashtë ministrisë, që do ndikonte në inspektim të pavarur për të vlerësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve dhe administrimin e licencimit. Inspektimi duhet të vlerësojë të gjithë ofruesit e shërbimeve, publik dhe privat.

Si pasojë e mos pasjes së kompetencave ekzekutive, rekomandimet e dhëna nga kjo njësi për ofruesit e shërbimeve sociale, nuk zbatohen. Kjo ndodhë për shkak të mos-definimit të rolit të inspektimit, ku njësia për inspektim nuk ka asnjë mandat ekzekutimi. Po ashtu, brenda njësisë

ekzistuese për inspektim ka mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe financiare për të bërë vizita efektive në terren, përkatësisht për të mbuluar gjithë territorin e Kosovës. Fuqishëm propozohet të bëhen investime në krijimin dhe fuqizimin e njësisë së inspektimit përmes dhënies së kompetencave ekzekutive dhe ofrimit të kapaciteteve të nevojshme për kryerjen e funksioneve të kërkuara.

Po ashtu, nuk ka monitorim të mirëfilltë nga ana Komunave. Bazuar në të dhënat nga monitorimi i KOMF, monitorimi nga niveli lokal bëhet vetëm përmes raporteve që ofruesit e shërbimeve i dërgojnë në këto drejtori. Ndërkaq monitorimi në terren nuk mund të bëhet për shkak të mungesës së kapaciteteve. Në anën tjetër, ofruesit shërbimeve sociale pohojnë se po ballafaqohen me paqartësi lidhur me raportimin, monitorimin dhe inspektimin. QPS-të në periudha të rregullta kohore (ditore, mujore dhe vjetore), hartojnë raporte të ndryshme për DSHMS dhe për MPMS. Për këtë, rekomandohet të bëhet përcaktimi i qartë i mekanizmave të raportimit.

Ligji në fuqi për Shërbime Sociale dhe Familjare nuk parasheh aplikimin e masave, gjobave dhe sanksioneve në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, ku për pasojë edhe llogaridhënia karshi përfituesve mbetet shumë e ulët. Prandaj, aplikimi i masave, gjobave

dhe sanksioneve do të ndikonin në rritjen e llogaridhënies. Propozohet që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare të parashikojë masat, gjobat dhe sanksionet në rast të shkeljes së dispozitave ligjore të këtij ligji. Masat, gjobat dhe sanksionet mund të përfshinë: marrjen e licencës si ofrues i shërbimeve sociale, shqiptimin e gjobave, masat penale konform Kodit Penal të Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale.

Rekomandohet që të ardhurat nga gjobat dhe sanksionet të dedikohen për kategori dhe shërbime sociale.

Në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare nuk ka monitorim të jashtëm të realizuar nga shoqëria civile dhe kjo është një mangësi. Krahas monitorimit nga komunat, inspektimit të pavarur nga MPMS, rekomandohet që ligji të parashikojë mundësinë e monitorimit nga sektori joqeveritar/privat. Kjo do të ndikonte në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe rritjen e llogaridhënies.

PROPOZIMI 7

Më qëllim të sigurimit të financimit të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale në tërë Kosovën, KOMF, Institucioni i Avokatit të Popullit, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Lidhja e QPS-ve, rekomandojnë që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare të parashikojë:

- Hartimin e standardeve financiare për secilin shërbim social (kostimi i shërbimeve, krijimi i formulës së financimit)
- Krijimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale, financimi sipas indikatorëve social dhe numrit të përfituesve

Arsyetim:

Mungesa e një Granti Specifik për Shërbime Sociale pamundëson ofrimin e shërbimeve cilësore minimale për mbrojtjen e fëmijëve dhe pengon mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tyre. Nëse vazhdohet me këtë formë të financimit gjendja mund të keqësohet për aq sa ta sjellë Qendrat për Punë Sociale dhe organizatat jo qeveritare në jofunksionale, e në rastet e tjera, qendrat dhe organizatat me performancë më të ulët, nuk do të mund të ofrojnë shërbime të tilla.

Aktualisht, ende nuk është bërë kostimi i shërbimeve sociale, nuk është hartuar formula e financimit për shërbime sociale dhe nuk është krijuar plani për financim të qëndrueshëm të shërbimeve sociale. Komunat nuk kanë krijuar një skemë të qëndrueshme të kontraktimit për blerjen e shërbimeve sociale nga sektori jo-qeveritar apo ai privat, aktualisht mbështetja ndaj OJQ-ve ofrohet në baza ad hoc dhe përmes subvencionimit. Kjo mënyrë e financimit po ndikon në shuarjen e shërbimeve të ofruara nga publik dhe sektori jo-qeveritar, prandaj rekomandohet ndërhyrje e menjëhershme për krijimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale.

Zgjidhja do të ishte: Krijimi i planit për financim të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale në tërë Kosovën përmes krijimit të Grantit për Shërbime Sociale.

Gjithashtu rekomandohet hartimi i standardeve financiare për secilin shërbim (kostimi i shërbimeve, formula e financimit) për të garantuar një financim të shërbimeve sociale e familjare, në mënyrë të duhur dhe në të njëjtën kohë për t'i venë ato në linjë me standardet minimale të cilësisë. Pa standarde fi-

nanciare, është vështirë të sigurohet buxheti adekuat, i qëndrueshëm dhe i mjaftueshëm për shërbime.

Është e domosdoshme të përcaktohet përqindja e buxhetit nacional dhe buxheteve të tjera komunale të ndara për shërbimet sociale. Buxheti nacional duhet të shpërndahet bazuar në një formulë financimi, e cila krijohet duke marrë për bazë numrin e banorëve, numrin e rasteve në nevojë për mbrojtje dhe shërbime, indikatorët social etj.

Organizatat anëtare të KOMF, janë:

Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim - AS-TRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof / CIPOF, Education Comes First - ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti - ORA, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror - OFAP, OPFAKOS, Programi për të Drejtat civile - CRP/ K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës - KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore - PVPT, Qendra për Studime të Avancuara - FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët në Kosovë - SDSF, Shoqata e Të Drejtave Të Pacientëve në Kosovë - Prak Kosovë, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës - HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VO-RAE, World Vision, Public Organization for Local Initiatives and Supports - POLIS, Network of Peace Movement – NOPM, SOS Kopshti, Nevo Koncepti, Qendra “Labyrinth” dhe Organizata Jo-Qeveritare Peer Education Network – PEN.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

Zenel Salihu, OB.1 HY.1 K.3 No.16, 10000
Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 220 287

Email: info@komfkosova.org

Web: www.komfkosova.org

Financuar nga:



European
Union
Kosovo



Implementuar nga:

